



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 7/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga anëtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Adnan Konushevcu dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Valbona Millaku, duke vendosur lidhur me apelin e Iniciativës Politike “Partia e Balliste” (PB), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me Nr.744/2019 të datës 18.07.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos regjistrimit të Iniciativës Politike “Partia e Balliste” në regjistrin e partive politike, në seancën e panelit të mbajtur me 22. 07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli Anr.7/2019 i datës 19.07.2019 i parashtruar nga Iniciativa Politike “Partia Balliste” (PB), me seli në Prishtinë.

II. ANULOHET vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me Nr.744/2019 të datës 18.07.2019, dhe **çështja i kthehet në rishqyrtim KQZ-së.**

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 19.07.2019 ka pranuar një apel nga Iniciativa Politike “Partia Balliste” (PB) paraqitur nga Lulzim Ponosheci, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Nr.744/2019 të datës 18.07.2019, me të cilën i është refuzuar kërkesa për regjistrim e subjektit politik në regjistrin e partive politike me numër rendor 54/2019 me kryesues Pajazit Podrimçaku.

Parashtruesi i apelit thekson se mos regjistrimi i Iniciativës Politike “Partia Balliste” me akronim PB është i kundërligjshëm pasi që iniciativa në fjalë konform nenin 12 të LZP-së, si dhe obligimet e përcaktuara me nenin 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 01/2013 të KQZ-së për Regjistrimin të Partive Politike ka zbatuar të gjitha procedurat për regjistrim. Në periudhën 7 deri me 13 qershor 2019 Iniciativa Politike “Partia Balliste” (PB), ka qenë në shqyrtim publik për regjistrimin si parti politike në gazetën ditore dhe në web faqen e KQZ-së, me çka sipas parashtruesit të apelit i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për regjistrim. I ka propozuar panelit që apeli të miratohet si i bazuar dhe të anulohet si i

kundërligjshëm vendimi i KQZ-së dhe çështja ti kthehet të njëjtit organ për rishqyrtim.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim – ZRPPC e KQZ-së në përgjigjen e saj me nr. protokolli 343 të datës 19.07.2019, parashtron se nga ana e ZRPPC-së është përgatitur materialin për regjistrim dhe me të njëjtin e ka njoftuar KQZ-në. Procedura e aplikimit ka qenë konform Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Nr. 01/2013.

Kërkesës për regjistrim i është bashkangjitur: Shkresa nga Zyra për Iniciativën Politike “Partia Balliste” (PB), shqyrtimi publik në gazetën ditore me datën 08 qershor 2019 dhe në web faqen e KQZ-së nga data 7 qershor deri me 13 qershor 2019 (linkun), rekomandimin për KQZ-në datës 14.06.2019, vendimin e KQZ-se të datës 18.07.2019, njoftimin nga Zyra me vendimin e KQZ-së datës 19.07.2019 për Iniciativën Politike “Partia Balliste” dhe për të drejtën e ankesës në PZAP (brenda 24 orëve)

Si dëshmi shtese ZRPPC-KQZ ka bashkangjitur komplet aplikacionin e aplikimit nga Iniciativa në fjalë si:

Formulari i regjistrimit, Aktin e Themelimit, Programin, Statuti, Fletëpagesën, Logon Dhe Deklaratën financiare.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 18.07.2019 me numër protokolli 744/2019 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të ZRPPC - KQZ gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se ZRPPC-së me datës 14.06.2019 ka rekomanduar KQZ-në se Iniciativa Politike “Partia Balliste” me akronim PB, i ka plotësuar kushtet ligjore për tu regjistruar në regjistrin e Partive Politike. KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.0.2019, nuk e ka miratuar rekomandimin e ZRPPC-së, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të atakuar. Në arsyetim të vendimit të atakuar KQZ-ja ka theksuar ZRPPC i ka rekomanduar KQZ-së se Iniciativa Politike “Partia Balliste” (PB) i ka përmbushur të gjitha kriteret për regjistrim konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe obligimet e caktuara me nenin 3 dhe 4.1 të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, dhe në periudhën prej shtatë (7) ditësh nuk ka pranuar asnjë ankesë përkitazi me aplikimin për regjistrimin e iniciativës së lartpërmendur, andaj pas hedhjes në votim në KQZ të rekomandimit të ZRPPC-së për regjistrimin e Iniciativës Politike “Partia Balliste”, nuk ka marre votat

e mjaftueshme për regjistrim si parti politike në të cilin votim shtatë (7) anëtarë të KQZ-së, kanë votuar pro dhe një (1) anëtarë ka votuar kundër. Andaj duke u bazuar në nenit 63 para. 4, iniciativa në fjalë nuk është regjistruar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendimin e atakuar të KQZ-së, nuk mund ta pranoi si të drejt dhe të ligjshëm meqenëse se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 12 paragrafi 3 të LZP-së, që i referohen regjistrimit të subjekteve politike dhe të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së, për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike ku me nenin 5 të kësaj Rregulle në mënyrë shprehimore janë paraparë arsyet për refuzimin e regjistrimit të një subjekti politik. Në rastin konkret në vendimin e goditur nuk është dhënë asnjë arsye ligjore mbi bazën e se cilës është refuzuar regjistrimi i subjektit politik në fjalë. Arsyet e dhëna mbi refuzimin e kërkesës nuk paraqesin bazë ligjore në kuptim të dispozitës së nenin 5 të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së, mbi bazën e së cilës do të lihej në fuqi vendimi i goditur.

Nga arsyet e cekura Paneli vendosi që ta miratoj apelin (si ne propozim) dhe vendimin e ankimuar të KQZ-së, ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje KQZ-së.

Me rastin e rivendosjes KQZ-ja sërish do të vlerësoj bazueshmërinë e kërkesës për regjistrim të Iniciativës Politike "Partia Balliste", duke ju referuar nenit 5 të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së dhe pas vlerësimit të gjitha provave të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 7/2019 më datën 22. 07.2019

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.



Kryesuesi i Panelit,
Gyltene Sylejmani